



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 17 shkronja o të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040 dhe nenit 19 shkronja o të Statutit të Komunës, nr. 01-1/298-10 të datës 12 tetor 2009, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2012, miratoi:

### **VENDIM**

## **PËR EMËRTIMIN “SHESHI I DËSHMORËVE” DHE VENDOSJEN E MONUMENTIT TË TRE HERONJËVE**

#### **Neni 1**

Sheshi afër Postës së qytetit dhe pallateve të banimit emërtohet:

“ Sheshi i Dëshmorëve “

#### **Neni 2**

Në Sheshin e Dëshmorëve të vendoset Monumenti i tre Heronjëve të Kosovës, Zahir Pajaziti – Hakif Zejnullahu – Ilir Konushefci.

#### **Neni 3**

Obligohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të caktojë pozitën dhe kushtet tekniko urbane për vendosjen e monumentit.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi pas miratimit, përkatësisht 8 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

**Nr. 01/16-02**  
**Podujevë,**  
**30 janar 2012**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Hazir Raçi**